



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr 46 date 27/04/2001

**PER  
TARIFAT E SHERBIMEVE QE OFRON DREJTORIA E PERGJITHSHME E  
PLANIFIKIMIT URBAN**

Mbështetur në nenin 113.2 të Kyshtetutës, dhe në ligjin 8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverusjes Vendore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I**

1. Niveli i tarifave për shërbimet që ofron Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Urban, të jetë si më poshtë:

- a. Dhënia e dokumentacionit për lejet e ndërtimit: 3.000 lekë
- b. Kontrolli i piketimit të objekteve: 3.200 lekë
- c. Kontrolli pas përfundimit të themeleve: 3.200 lekë
- d. Kontrolli pas përfundimit të karabinas: 2.000 lekë/kat
- e. Kontrolli i sistemimit të ambjentit rrethues pas përfundimit të punimeve: 3.200 lekë
- f. Akt-kontrolli i përfundimit të punimeve për kërkesën për leje shfrytëzimi: deri 3 kate: 8.000 lekë  
mbi 3 kate: +1.000 lek/kat
- j. Fotokopjimi i planshtesave në shkallë 1:2000:
  - Format A4: 400 lekë
  - A3: 600 lekë
  - A2: 800 lekë
  - A1: 1.200 lekë
  - A0: 2.000 lekë
- h. Azhornimi i genplanelaneve: 20 lek/m<sup>2</sup>  
(azhornimi përfshin edhe një brez 20 m përreth pronës)
- i. Dhënia e genplanit të paazhonuar të zonës ku do të ndërtohet, për subjektet private: Format A4: 1.200 lekë  
“ A3: 3.200 lekë

j. Rilevimi, azhornimi dhe përgatitja e planshetave: 10 lek/m<sup>2</sup>  
k. Matja, përcaktimi i zonës së vendodhjes së objektit (për efekt çmimi) dhe azhornimi i genplanit në rastet e dhënies me qera ose për privatizim tërësor apo pjesor të truallit: 6.000 lekë

2. Për pikat **1.a, 1.b, 1.c, dhe 1.e**, kur objekti është mbi 3 kate, tarifat e mësipërme dyfishohen

3. Tarifat e mësipërme shumëzohen me koeficientin e mëposhtëm:

Për zonën 1 të Tiranës aplikohet 100% e tarifës

Për zonën 2 të Tiranës aplikohet 75% e tarifës

Për zonën 3 dhe 4 të Tiranës aplikohet 50% e tarifës

4. Kryetari i Bashkisë, ruan të drejtën që për raste të veçanta (për arsye humanitare apo interesash shtetërore, bashkiake apo të komunitetit), të urdhërojë ofrimin e shërbimeve të mësipërme pa pagesë apo me zbritje 50% nga tarifa

5. Komisioni i Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Ish-pronarëve, në praktikat dhe shërbimet e veta ndaj qytetarëve, përdor tarifat e përcaktuara në pikat **1.j, dhe 1.i** të këtij vendimi.

6. Ngarkohet Bashkia e Tiranës me zbatimin e këtij vendimi.

7. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**